



Data 06.11.2025

Ceremonia e hapjes se Lojrave te 6-ta te Solidaritetit Islamik, ne te cilen ekipi yne prej 11 pjesemarresish parakaloi, i udhehequr nga dy flamur mbajtesit : Enkileda Carja dhe Ertjan Kofsha.

Data 09.10.2025 ishte dita e nisjes se Gares se pare per ekipin Team Albania. Garen e nisi **Erisa Brahimaj – Judo**, e cila nuk arriti te kalonte fazen e pare eliminatorre, duke mos marre ne keto Lojra nje rezultat te kenaqshem.

Data 10.11.2025 ishte dita kur garoi **Enkileda Carja - Peshengritje**, e cila mori **tre medalje argjendi**, si dhe u shpall **rekord boteror per moshen** e saj.

Data 11.11.2025 ishte data kur u zhvilluan keto gara :

1. **Ertjan Kofsha - Peshengritje**, i cili arriti te merrte **vendin e 4-t** nga 57 shtete pjesemarrese ne keto Lojra.
2. **Melos Gashi – Karate**, i cili gjithashtu arriti te merrte vetem **vendin e 5-te**.
3. **Orges Arifi – Karate**, i cili nuk pati rezultat te kenaqshem ne keto Lojra, si dhe
4. **Kejdi Kalaja – Ping Pong**, i cili pavareisht se e kaloi fazen e pare eliminatorre, perseri nuk arriti te kaloje fazen e dyte, duke marre si rrjedhoje nga ne keto Lojra nje rezultat jo fort te kenaqshem.

Data 15.11.2025 perkon me garen e **Ernest Merdanaj – Taekwondo** i cili, beri nje gare shume te bukur, duke qene ne gare me kundertshtare qe peshonin rreth 10 kg mbi peshen e tij reale, por pavaresisht asaj, ai nuk arriti te vijonte me tej rrugetimin e tij ne Lojrat Islamike.

Data 21.11.2024 ishte dita e Ceremonise se mbylljes e Lojrave te 6-ta te Solidaritetit Islamik, ceremoni e cila u zhvillua ne mbremje, ne ora 20.30 dhe, per Team Albania parakaluan Zelimkhan Abakarov si flamur mbajtes, i shoqeruar nga do traineret dhe nga Shefja e Misionit.